Aksioneri Z. Paulin Sterkaj kërkon të tërhiqet nga shoqëria nëpërmjet shitjes së aksioneve që ai zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë në masën 25% dhe për këtë arsye propozon që blerja e aksionerëve të tij të bënet nga aksionerët e shoqërisë. Sipas këtij propozimi, aksioneri Luigj Alijaj ka shfaqur interesin e tij për blerjen e këtyre aksioneve, duke sjellë si rezultat rritjen e përqindjes së aksioneve që ai zotëron në kapitalin themeltar në masën 50%. Aksionerët e tjerë të shoqërisë janë dakort për realizimin e këtij operacioni ndërmjet Z. Paulin Sterkaj dhe Z. Luigj Alijaj, pas të cilit aksioneri Paulin Sterkaj humbet cilësinë e aksionerit të Shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" Sh.A. si dhe çdo të drejtë apo detyrim që mund të lind nga kjo cilësi.

***Për pikën e parë të rendit të ditës, Asamblea e Jashtëzakonshme vendos me unanimitet shitjen e aksioneve të shoqërisë në masën 25% nga aksioneri Paulin Sterkaji, i cili e humbet këtë cilësi dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër Luigj Alijaj, i cili bëhet zotërues i 50% të aksioneve në kapitalin themeltar gjithsej.***

Aksioneri i Shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" Sh.A, Shoqëria Tregtare "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k., zotëruese e 25% të kapitalit të shoqërisë, kërkon shitjen e aksioneve të saj tek persona të tretë jashtë shoqërisë, meqënëse asnjë prej aksionerëve nuk ka shfaqur interes për blerjen e tyre. Propozohet që këto aksione të shiten në favor të Z. Shefqet Kastrati dhe të gjithë aksionerët bien dakort me të. Me realizimin e këtij operacioni shitje aksionesh, aksioneri shitës Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k. do të humbasë pronësinë e tij mbi aksionet e zotëruara në shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" Sh.A. në masën 25% të aksioneve dhe duke humbur cilësinë e aksionerit të shoqërisë. Ndërsa bleresi Z. Shefqet Kastrati, përveç pronësisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi aksionet prej 25%, do të fitojë dhe cilësinë e aksionerit të shoqërisë.

***Për pikën e dytë të rendit të ditës, Asamblea e Jashtëzakonshme vendos me unanimitet shitjen e aksioneve të shoqërisë në masën 25% nga aksioneri Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k. që e humbet këtë cilësi dhe blerjen e tyre nga Z. Shefqet Kastrati, i cili bëhet aksioner i shoqërisë, zotërues i 25% të aksioneve në kapitalin themeltar.***

Pas realizimit të dy operacioneve të mësipërme, kapitali themeltar i shoqërisë do të zotërohet në këtë mënyrë:

- ***Aksioneri Luigj ALIJAJ është zotërues i masës prej 50% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;***
- ***Aksioneri Leonard Kastrati është zotërues i masës prej 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;***
- ***Aksioneri Shefqet Kastrati është zotërues i masës prej 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.***

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, në përfundim të mbledhjes, dhe duke mos patur pikë tjetër për dikutim, në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë,

**VENDOSI:**

**1-** Miratimin e shitjes së 25% aksioneve nga aksioneri Paulin Sterkaj, i cili humbet cilësinë e aksionerit në shoqëri, dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër Luigj Alijaj, i cili bëhet zotërues i 50% të aksioneve.

**2-** Miratimin e shitjes së 25% të aksioneve nga aksioneri "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k. që humber cilësinë e aksionerit dhe blerjen e tyre nga Z. Shefqet Kastrati i cili bëhet aksioner i shoqërisë, zotërues i 25% të kapitalit themeltar.

**3-** Kapitali i shoqërisë, pas realizimit të shit-blerjeve si më sipër zotërohet si më poshtë:

- *Aksioneri Luigj ALIJAJ është zotërues i masës prej 50% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;*
- *Aksioneri Leonard Kastrati është zotërues i masës prej 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;*
- *Aksioneri Shefqet Kastrati është zotërues i masës prej 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.*

**4-** Ngarkohet Drejtori i Shoqërisë me depozitmin e ndryshimeve në Regjistrin Tregtar.

**AKSIONERËT**

**Luigj ALIJAJ**

**Leonard KASTRATI**

**ULDEDAJ LIS SHPK**
**Përfaqësuar nga**
**Gjoke ULDEDAJ**

**Paulin STERKAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE - TIRANE

---

Nr. 634 Rep. Tirane me 04/11/2005

## VERTETIM

Vertetohet se sot me date. 04/11/2005, para meje notere Frida MUCMATA ,me seli ne Bul"Zhan D'Ark"prane Ures se Tabakeve ,u paraqiten personat e mesiperm :

1.Z.Luigj ALIAJ ,shtetas Shqiptar ,lindur me 05/11/1959 ,ne Shkoder dhe banues ne Shkoder ,madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me Nr Pasaporte 1517472
2.Shoqeria "ULDEDAJ LISS" Sh.p.k perfaqesuar sipas vendimit te asamblese te ortakeve te dates 27/10/2005 nga Z.Gjoke ULDEDAJ ,lindur me 03/03/1959,banues ne Tirane ,madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me Pasaporte Nr.0162242.
3.Leonard KASTRATI ,lindur me 19/11/1984 ,ne Kukes dhe banues ne Dures ,madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i njohur personalisht prej meje .
4.Paulin STERKAJ ,lindur me 05/07/1961 , banues ne Tirane ,madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me Pasaporte Nr.0084382.

Te cilet me deklaruan se sa mesiper ,eshte vendimi i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve të shoqërisë "A.K.U.S.GROUP"Sh.a e ka hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote,e neneshkruar para meje , dhe une noterja pasi e gjej te rregullt e vertetoj ate sipas ligjit .

PULLE TAKSE

N O T E RE
Frida MUÇMATA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 31 **Kol.**
**Nr.** 621. **Rep.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË FRIDA B. MUÇMATA NOTER TIRANË

**KONTRATË**
**SHIT – BLERJE AKSIONESH**

Sot, më datë 31/10/2005, para meje Frida Muçmata Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht, Shitësi dhe Bleresi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Aksionesh me termat e mëposhtme :

**SHITËSI :** Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k., e regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 9213, datë 24.02.1995, përfaqësuar sipas Vendimi të Asamblesë së Ortakëve të datës 27.10.2005 nga Z. Gjoke Uldedaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 03.03.1959, banues në Tiranë në adresën Rruga "Mine Peza" Nr. 88, Shalla 1/19, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar sipas pasaportës me nr. 0162242, me cilësinë e Aksionerës së Shoqërisë Tregtare "A.K.U.S. GROUP" Sh.A., në të cilën zotëron 25% të kapitalit themeltar.

**BLERËSI :** Z. Shefqet Kastrati, shtetas shqiptar i datëlindjes 05.06.1961, lindur në Kukës dhe banues në Durrës në adresën "Currila", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. 1513303.

**OBJEKTI:** Shitja e aksioneve të shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" sh.a. në masën prej 25% të aksioneve të kapitalit themeltar, aksione këto të zotëruara tërësisht nga Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k., me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga Z. Shefqet Kastrati, me cilësinë e bleresit.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria Tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 23554, datë 06.04.2000. Shoqëria është themeluar me një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000.000 lekë.

Me vendimin e datës 28.10.2005 të Asamblesë së Aksionerëve të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së aksioneve, nga aksioneri Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k. në tërësinë e aksioneve që ajo zotëron në masën 25% të kapitali themeltar në favor të një personi jashtë shoqërisë.

Shitësi, aksioneri "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k. ka vendosur që aksionet e tij të shiten në favor të blerësit Z. Shefqet Kastrati.

Shitja e totalit prej 25% të aksioneve të kapitalit themeltar të Shoqërisë Tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a., sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të aksionerit Shoqërisë "ULDEDAJ LIS" në masën 25% të tyre, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje të realizuar ndërmjet palëve.

Shitësi, është plotësisht dakort t'i shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, Blerësit, Z. Shefqet Kastrati vlerën prej 25% të aksioneve të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Nga ana e tij Blerësi, Z. Shefqet Kastrati është plotësisht dakort që të blejë masën prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a. Pas këtij trasanksioni, Blerësi fiton cilësinë e aksionerit të shoqërisë së sipërpërmendur, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që sjell blerja e aksioneve, si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve.

## MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi, Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k. humbet pronësinë mbi masën prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" sh.a., duke humbur cilësinë e saj si aksionere e shoqërisë dhe duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi aksionet e kësaj shoqërie. Ndërsa Blerësi, Z. Shefqet Kastrati bëhet pronar i të gjithë aksioneve të shitura të kapitalit themeltar të shoqërisë në masën 25% të tyre.

Pas realizimit të kësaj kontrate shit – blerje, aksionet e shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" sh.a. do të zotërohen në këtë mënyrë:

- Luigj Aliaj zotëron 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Leonard Kastrati zotëron 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Paulin Sterkaj zotëron 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Shefqet Kastrati zotëron 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë

## ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje të aksioneve të shoqërisë tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a. do të jetë 25.000.000 (njëzet e pesë milion) lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të një aksioni.

Sipas këtij përcaktimi Blerësi, Z. Shefqet Kastrati, paguan në favor të Shitësit Shoqërisë "ULDEDAJ LIS" shumën 25.000.000 (njëzet e pesë milion) lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrit Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time.

**PALËT**

| **SHITËSI** | **BLERËSI** |
|---|---|
| **Shoqëria "ULDEDAJ LIS" Sh.p.k.**<br>Përfaqësuar nga<br>**Gjoke ULDEDAJ** | **Shefqet KASTRATI** |

**NOTER**

Fudo Muçmoto

PULLE TAKSE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 32 **Kol.**
**Nr.** 622 **Rep.**

**KONTRATË**
**SHIT – BLERJE AKSIONESH**

Sot, më datë 31/10/2005, para meje Frida Mucmata Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht, Shitësi dhe Bleresi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Aksionesh me termat e mëposhtme :

**SHITËSI :** Paulin Sterkaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.07.1961, banues në Tiranë në adresën rruga "Irfan Tomini", Selitë 1, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. 0084382, me cilësinë e aksionerit të Shoqërisë Tregtare "A.K.U.S. GROUP" Sh.A., në të cilën zotëron 25% të kapitalit themeltar.

**BLERËSI :** Z. Luigj Alijaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.11.1959, banues në Shkodër në adresën Rruga "Marlin Barleti", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet paportës me nr 1517472, aksioner i Shoqërisë Tregtare "A.K.U.S. GROUP" Sh.A., në të cilën zotëron 25% të kapitalit themeltar.

**OBJEKTI:** Shitja e aksioneve të shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" sh.a. në masën prej 25% të aksioneve të kapitalit themeltar, aksione këto të zotëruara tërësisht nga Z. Paulin Sterkaj, me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre mga Z. Luigj Alijaj, me cilësinë e blerësit.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria Tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 23554, datë 06.04.2000. Shoqëria është themeluar me një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000.000 lekë.

Me vendimin e datës 28.10.2005 të Asamblesë së Aksionerëve të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së aksioneve, nga aksioneri Z. Paulin Sterkaj në tërësinë e aksioneve që ai zotëron në masën 25% të kapitali themeltar në favor të aksionerit tjetër të shoqërisë Z. Luigj Alijaj.

Shitja e totalit prej 25% të aksioneve të kapitalit themeltar të Shoqërisë Tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a., sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të askionerit Z. Paulin Sterkaj në masën 25% të tyre, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje të realizuar ndërmjet palëve.

Shitësi, është plotësisht dakort t'i shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, Blerësit, Z. Luigj Alijaj vlerën prej 25% të aksioneve të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Nga ana e tij Blerësi, Z. Luigj Alijaj është plotësisht dakort që të blejë masën prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a. Pas këtij trasanksioni, Blerësi fiton të gjitha të drejtat dhe detyrimet që sjell blerja e aksioneve në masën 25% të tyre, duke rritur përqindjen e zotërimit të aksioneve të tij në kapitalin themeltar në masën 50% të aksioneve.

## MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi, Z. Paulin Sterkaj humbet pronësinë mbi masën prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" sh.a., duke humbur cilësinë e tij si aksioner të shoqërisë dhe duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi aksionet e kësaj shoqërie. Ndërsa Blerësi, Z. Luigj Alijaj bëhet pronar i të gjithë aksioneve të shitura të kapitalit themeltar të shoqërisë në masën 25% të tyre dhe gjithsej i masës 50% të kapitalit të shoqërisë.

Pas realizimit të kësaj kontrate shit – blerje, aksionet e shoqërisë "A.K.U.S. GROUP" sh.a. do të zotërohen në këtë mënyrë:

- Luigj Alijaj zotëron 50% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Leonard Kastrati zotëron 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Shefqet Kastrati zotëron 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.

## ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje të aksioneve të shoqërisë tregtare "A.K.U.S. GROUP" sh.a. do të jetë 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë.

Sipas këtij përcaktimi Blerësi, Z. Luigj Alijaj, paguan në favor të Shitësit Z. Paulin Sterkaj shumën 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

## DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrit Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time.

**PALËT**

| SHITËSI | BLERËSI |
|---|---|
| Paulin STERKAJ | Luigj ALIJAJ |
| Paulin Sterkaj | Luigj Alijaj |

**NOTER**

Frida Muçmata

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FRIDA MUÇMATA
NOTER
TIRANË

23554/2

12 12 2005

17 DHJETOR 2005

# KERKESE

**KERKUES** : Z.**Shefqet JATA**,i biri i Rexhepit ,lindur më 14/01/1960 në Kukës dhe banues në Tiranë identifikuar me Pasaportë Nr.0841262 drejtori i shoqerise “CONTINENTAL GROUP” Sh.a

**OBJEKTI** :Depozitimi ne Rregjistrin Tregetar te vendimit Nr.1 date.05/12/2005 te asamblese te jashtezakonshme te shoqerise “CONTINENTAL GROUP” Sh.a .

**PARA GJYKATES TE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

I neneshkruari Shefqet JATA ne cilesine e Drejtorit te Shoqerise Vendimit Nr.1 te Asamblese te Jashtezakonshme te shoqerise “CONTINENTAL GROUP” Sh.a ,e marre nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve ne date 05/12/2005 votuar ne unanimitet nga te gjithe aksioneret ,mbeshtetur ne percaktimet e statutit te shoqerise dhe Ligjin Nr. 7638 datë 19/11/1992 “Per shoqerite Tregetare “.

Asambleja e jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise “CONTINENTAL GROUP ”Sh.a ne mbledhjen e saj te dates 05/12/2005 ka vendosur :

- Ndryshimin e emertimit te shoqerise nga “**A.K.U.S GROUP** “sh.a ne “CONTINENTAL GROUP”Sh.a.
- Zgjidhjen e keshillit mbikqyres te perbere nga 4 persona dhe konkretisht **Luigj ALIAJ** kryetar **Shefqet KASTRATI** Zv/kryetar **Gani KASTRATI , Leonard KASTRATI** anetar
- Emerimi i Drejtorit te Drejtorise te Shoqerise “CONTINENTAL GROUP ”Sh.a Z. **Shefqet JATA**
- Emerimi i ekspertit Kontabel te autorizuar ,per kontrollin e llogarive te shoqerise ,Z. **Paqësor QATO**

Dukeqenese dokumentet e pasqyrojne çka parashkruam me larte ,jane bere mbi bazen e ligjes dhe jane te legalizuara nga noteri ,lutemi te na pranohet kerkesa si e bazuar ne ligje dhe te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregetar te depozitoje aktet dhe te beje shenimet perkatese ne Rregjister.

**KERKUESI**
Per “**CONTINENTAL GROUP**”sh.a
Drejtori
Shefqet JATA

Tirane,me 08/12/2005

Shefqet Jata

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr.** 882 **Rep**

# VERTETIM

Ne Tirane ,me 09/12/2005(dymijepese) para meje notere Frida MUÇMATA ,me studio ne Bul."Zhan D'Ark " u paraqit personalisht Z.**Shefqet JATA**,i biri i Rexhepit ,lindur më 14/01/1960 në Kukës dhe banues në Tiranë identifikuar me Pasaportë Nr.0841262 drejtori i pergjithshem i shoqerise "CONTINENTAL GROUP" Sh.a i cil firmosi ne pranine time kete kerkese drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ,dhe une noteria vertetoj firmen e tij sipas ligjit .

**NOTERE**
**FRIDA MUÇMATA**

PULLE TAKSE

**SHOQËRIA TREGËTARE**
**"A.K.U.S GROUP" SH.A**

**Tiranë,më 05/12/2005**

**VENDIM**
**I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME**
**TË AKSIONERËVE**

Sot, më datë 05/12/2005 ,pranë selisë të shoqërisë u mbajt mbledhja e Asamblesë të Jashtëzakonshme të Shoqërisë për të diskutuar vendimin nr.1 dhe vendosur mbi rendin e ditës të njoftur sipas rregullave në fuqi si më poshtë vijon :

1. Miratimin e ndryshimit të emërtimit të shoqërisë"**A.K.U.S GROUP**"Sh.A .
2. Miratimi i Organeve Drejtuese të Shoqërisë "**A.K.U.S GROUP**"Sh.A
3.Të ndryshme .

Asambleja e Jashtëzakonshme ,në prezencë të të gjithë aksionereve të shoqërisë ,të cilët përfaqësojnë 100 % kapitalin themeltar ,proceduan me shqyrtimin e pikës të parë të rendit të ditës .

1.Aksionerët kërkojnë të bëjnë ndryshimin e emërimit të Shoqërisë nga "**A.K.U.S GROUP**"Sh.a në "**CONTINENTAL GROUP**"Sh.a dhe janë dakort me unanimitet për realizimin e këtij ndryshimi .
2.Aksionerët vendosen me unanimitet që të ndryshojnë si më poshtë vijon ,këto Organe Drejtuese :
a)Drejtori i përgjithshëm i Shoqërisë : **-Shefqet JATA**
b)Kshilli Mbikqyrës i Shoqërisë të përbëhet nga:**-Shefqet KASTRATI**
**-Luigj ALIAJ**
**- Gani KASTRATI**
**-Leonard KASTRATI**
c)Kryetar i këshillit të Parë Mbikqyrës **- Luigj ALIAJ**
d)Ekspert Kontabël i shoqërisë **-Paqësor QATO**

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve në përfundim të mbledhjes ,dhe duke mos patur pikë tjetër për diskutim , në bazë të ligjit Nr.7638 datë 19/11/1992 "**Për shoqëritë Tregëtare dhe Statuti i Shoqërisë** " vendosi :

1. Miratimin e ndryshimit të emërtimit të shoqërisë"**A.K.U.S GROUP**"Sh.A në "**CONTINENTAL GROUP**"Sh.a .
2. Miratimi i Organeve Drejtuese të Shoqërisë "**A.K.U.S GROUP**"Sh.A si më poshtë vijon :
a)Drejtori i përgjithshëm i Shoqërisë : **-Shefqet JATA**

b)Kshilli Mbikqyrës i Shoqërisë të përbëhet nga:-**Shefqet KASTRATI**
**-Luigj ALIAJ**
**-Gani KASTRATI**
**-Leonard KASTRATI**

c)Kryetar i këshillit të Parë Mbikqyrës - **Luigj ALIAJ**
d)Ekspert Kontabël i shoqërisë **-Paqësor QATO**

Ngarkohet Drejtori i Shoqërisë të bëjë depozitimin e ndryshimeve në Rregjistrin Tregëtar.

**AKSIONERËT**

**Shefqet KASTRATI** **Luigj ALIAJ**

**Leonard KASTRATI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE - TIRANE**

---

**Nr.** 882 **Rep.** **Tirane me 05/12/2005**

VERTETIM

Vertetohet se sot me date.05/12/2005, para meje notere Frida MUÇMATA ,me seli ne Bul"Zhan D'Ark"prane Ures se Tabakeve ,u paraqiten personat e mesiperm :

**Z.Luigj ALIAJ**, shtetas shqiptar ,lindur më 05/11/1956 ,në Shkoder dhe banues në Shkoder ne Rr."Marlin Barleti",person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i njohur personalisht prej meje .

**Z.Leonard KASTRATI** , i biri i Shefqetit ,lindur më 19/11/1983 ,në Kukës dhe banues në Durës në adresën "Currila" ,person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i njohur personalisht prej meje .

**Z.Shefqet KASTRATI** ,shtetas shqiptar i biri i Jonuzit ,lindur më 05/06/1961 ,në Kukës dhe banues në Durës në adresën "Currila" person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr.0012701

Te cilet me deklaruan se sa mesiper ,eshte vendimi i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve të shoqërisë "A.K.U.S GROUP"Sh.a e ka hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote,e neneshkruar para meje , dhe une noterja pasi e gjej te rregullt e vertetoj ate sipas ligjit .

**N O T E RE**
**Frida MUÇMATA**

PULLE TAKSE

VENDIM N.1

I MBLEDHJES SE KSHILLIT MBIKQYRES TE SHOQERISE "CONTINENTAL GROUP" Sh.a.

Viti 2005 diten e peste te muajit dhjetor,ne Tirane ne seline e shoqeise ,ne oren 15.00,u mblodh kqshilli mbikqyres I shoqerise "CONTINENTAL GROUP" Sh.a. per emrimin e drejtorit te shoqerise.

Ne mbaledhje moren pjese antaret e Kshqshillit Mbikqyres te zgjedhur nga mbledhja e asamblese se jashtzakonshme e dates 05/12/2005; ,Shefqet Kastrati,Luigj Aliaj,Gani Kastrati dhe Leonard Kastrati,te cilet mbasi diskutuan rreth kandidaturave te propozuara per Kryetarin e Keshillit Mbikqyres dhe Drejtor te Pergjithshem te shoqerise,me unanimitet;

VENDOSEN

1. Kryetar i keshillit Mbikqyres Z.Luigj Aliaj.

2. Drejtor i Pergjitheshem i shoqerise "CONTINENTAL GROUP" Sh.a. Z.Shefqet Jata I cili e ka pranuar kete detyre dhe do te qendroje ne detyre per nje periudhe kater vjeçare, siç percaktohet ne statutin e shoqerise.

Ne perfundim te votimit ta hapur,duke mos pasur gje tjeter per te vendosur,mbledhja u mbyll ne ora 16.00 duke lexuar,aprovuar e neshkruar kete vendim.

ANTARET

**Shefqet Kastrati** **Gani Kastrati** **Leonard Kastrati**

**Kryetari**
**Luigj Aliaj**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE - TIRANE**

---

**Nr.** 882 **Rep.** **Tirane me 05/12/2005**

# V E R T E T I M

Vertetohet se sot me date.05/12/2005, para meje notere Frida MUÇMATA ,me seli ne Bul"Zhan D'Ark"prane Ures se Tabakeve ,u paraqiten personat e mesiperm :

**Z.Luigj ALIAJ**, shtetas shqiptar ,lindur më 05/11/1956 ,në Shkoder dhe banues në Shkoder ne Rr."Marlin Barleti",person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i njohur personalisht prej meje .

**Z.Leonard KASTRATI** , i biri i Shefqetit ,lindur më 19/11/1983 ,në Kukës dhe banues në Durës në adresën "Currila" ,person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i njohur personalisht prej meje .

**Z.Shefqet KASTRATI** ,shtetas shqiptar i biri i Jonuzit ,lindur më 05/06/1961 ,në Kukës dhe banues në Durës në adresën "Currila" person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr.0012701

**Z.Gani KASTRATI** ,shtetas shqiptar ,i biri i Nebiut ,lindur më 19/11/1951 ,në Kukës dhe banues në Durës person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ,i njohur personalisht prej meje.

Te cilet me deklaruan se sa mesiper ,eshte vendimi i mbledhjes te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "CONTINENTAL GROUP "Sh.a e ka hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote,e neneshkruar para meje , dhe une noterja pasi e gjej te rregullt e vertetoj ate sipas ligjit .

**N O T E RE**
**Frida MUÇMATA**

08 MAR. 2007

Tirane me 03 / 03 /2007

**KERKESE**

**KERKUES :** Zoti Shefqet Jata person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ne cilesine e drejtorit te shoqerise **" Continental Group "** **sh.a**

**OBJEKTI :** Depozitimi i vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise tregtare "Continental Group" sh.a. date 29. 01.2007

**PERPARA : GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**

**TIRANE**

**E nderuar Gjykate!**

Shoqeria „**"Continental Group" sh.a** " eshte regjistruar si person juridik ne baze te vendimit Nr. 23554/2 , dt. 16.12.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane , vendim ne te cilin ka gjetur pasqyrim vendimet marra nga asamblea e jashtezakonshme e aksionereve te shoqerise per ndryshimin emertimit te shoqerise ne "Continental Group" Sh.a, nga "A..k.u.s Group " sh.a qe ishte me pare, shoqeri shoqeri e rregjistruar me vendimin e gjykates nr 23554 date 06.04.2000 me kapital themeltar 100 000 000 leke , si dhe miratimi e Drejtorit te ri z. Shefqet Jata

Aksioneret e shoqërise "Continental Group" Sh.a jane :

- Aksioneri z. Luigj ALIJAJ është zotërues i masës prej 50% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Aksioneri Z.Shefqet Kastrati është zotërues i masës prej 25 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë
- Aksioneri Z.Leonard Kastrati është zotërues i masës prej 25 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë

Me vendimin e dates 29. 01. 2007, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise "Continental Group" Sh.a ka vendosur :

1. Miratimin e shitjes së 25% te aksioneve nga aksioneri z. Leonard Kastrati i cili humbet cilësinë e aksionerit në shoqëri, dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër z. Shefqet Kastrati , i cili bëhet zotërues i 25 % të aksioneve te shitura të kapitalit themeltar .

Kapitali i shoqërisë, pas realizimit të operacionit te shit-blerjes si më sipër do te zotërohet si më poshtë:

- *Aksioneri Luigj ALIJAJ është zotërues i masës prej 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;*
- *Aksioneri Shefqet Kastrati është zotërues i masës prej 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.*

Vendimi duhet depozituar ne Regjistrin tregtar per te bere te mundur pasqyrimin e ketyre ndryshimeve.

**KERKUES**

**SHEFQET JATA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE
T I R A N E

PULLE TAKSE

Nr.880.Rep
Tirane, me 03.03.2007

# V E R T E T I M :

Me anen e te cilit vertetoj se sot me daten 03.03.2007 (dymijeeshtate), u paraqit personalisht para meje Noterit Boris M. SKENDI, me Seli Rruga “Reshit COLLAKU”, Pall. “Shallvareve” Nr.4 Tirane, dhe me kerkoi konfirmimin noterial te nenshkrimit te tij ne kete kerkese drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per depozitim ne Rregjistrin Tregetar te asaj Gjykate te Akteve respektive: Vendim te Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve te “CONTINENTAL GROUP” SH.A. Nr.878 date 03.03.2007 dhe Kontrate Shitblerje Aksionesh te “CONTINENTAL GROUP” SH.A. Nr.880.Rep. – Nr.88.Kol. date 03.03.2007; Zoti Shefqet JATA Ai Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise, per identitetet e te cilit u sigurova nepermjet dokumenteve ligjore te Shoqerise dhe atyre individuale qe mban me vete, si dhe per nenshkrimin e vullneteshem sipas deklarimit te tij ne kete Zyre Noteriale, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pas une Noteri Publik e vertetoj ate sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.7829 date 01.06.1994 “Per Noterine”.

N O T E R I

Boris SKENDI

Shoqeria Tregtare " Continental Group " sh.a
Tirane

Tirane me date 04/03/2007

**AUTORIZIM**

Autorizoj avokatin z. GENTIAN METE per te kryer depozitimin ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane per rregjistrin tregtar te vendimit te asamblese date 29.01.2007 te ortakeve te shoqerise "Continental group"sh.a Tirane per shit- blerjen e aksioneve si dhe te kontrates se shit -blerjes se aksioneve te hartuar me date 03.03.2007.
Ky autorizim eshte i vlefshem vetem per depozitimin ne gjykate te dokumentave te mesiperme .

**DREJTORI**
**Shefqet JATA**

**SHOQËRIA TREGTARE**
**"CONTINENTAL GROUP " SH.A.**

**Tiranë, më 29.01.2007**

# VENDIM
# I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME
# TË AKSIONERËVE

Sot, më datë 29.01.2007, pranë selisë së Shoqërisë u mbajt mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës të njoftuar sipas rregullave në fuqi si më poshtë vijon:

1. Miratimi i shitjes së aksioneve të shoqërisë ndërmjet aksionerëve;
2. Miratimi i shitjes së aksioneve të shoqërisë nga njëri prej aksionerëve të saj, në favor të aksionerit tjeter brenda shoqërisë;
3. Të ndryshme.

Asamblea e Jashtëzakonshme, në prezencë të të gjithë aksionerëve të shoqërisë, të cilët përfaqësojnë kapitalin në masën 100%, proçeduan me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Aksioneri Z. Leonard Kastrati kërkon të tërhiqet nga shoqëria nëpërmjet shitjes së aksioneve që ai zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë në masën 25% dhe për këtë arsye propozon që blerja e aksioneve të tij të bëhet nga aksionerët e shoqërisë. Sipas këtij propozimi, aksioneri z. Shefqet Kastrati ka shfaqur interesin e tij për blerjen e këtyre aksioneve, duke sjellë si rezultat rritjen e përqindjes së aksioneve që ai zotëron në kapitalin themeltar në masën 50%. Aksionerët e tjerë të shoqërisë janë dakort për realizimin e këtij operacioni ndërmjet Z. Leonard Kastrati dhe Z. Shefqet Kastrati , pas të cilit aksioneri Leonard Kastrati do të humbasë pronësinë e tij mbi aksionet e zotëruara në shoqërisë "Continental Group " Sh.A. në masën 25% të aksioneve , duke humbur njekohsisht edhe cilësinë e aksionerit të shoqërisë. Ndërsa blerësi Z. Shefqet Kastrati, behet pronar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi aksionet e blera prej 25%, të shoqërisë "Continental Group " Sh.A duke zoteruar pas shitjes 50% te aksioneve te kesaj shoqerie .

***Për pikën e parë të rendit të ditës, Asamblea e Jashtëzakonshme vendos me unanimitet shitjen e aksioneve të shoqërisë në masën 25% nga aksioneri z.Leonard Kastrati , i cili e humbet këtë cilësi dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër z. Shefqet Kastrati , i cili bëhet zotërues i 25 % të aksioneve te shitura të kapitalit themeltar .***

Pas realizimit të operacioni të mësipërme, kapitali themeltar i shoqërisë do të zotërohet në këtë mënyrë:

- ***Aksioneri z. Luigj ALIJAJ është zotërues i masës prej 50% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;***
- ***Aksioneri Z.Shefqet Kastrati është zotërues i masës prej 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.***

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, në përfundim të mbledhjes, dhe duke mos patur pikë tjetër për dikutim, në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë,

Leonard Kastrati

**VENDOSI:**

1- Miratimin e shitjes së 25% te aksioneve nga aksioneri z. Leonard Kastrati , i cili humbet cilësinë e aksionerit në shoqëri, dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër z. Shefqet Kastrati , i cili bëhet zotërues i 25 % të aksioneve te shitura të kapitalit themeltar .

2- Kapitali i shoqërisë, pas realizimit të operacionit te shit-blerjes si më sipër do te zotërohet si më poshtë:

- *Aksioneri Luigj ALIJAJ është zotërues i masës prej 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;*
- *Aksioneri Shefqet Kastrati është zotërues i masës prej 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.*

3- Ngarkohet Drejtori i Shoqërisë me depozitimin e ndryshimeve në Regjistrin Tregtar.

**AKSIONERËT**

**Shefqet KASTRATI**

**Luigj ALIJAJ**

**Leonard KASTRATI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

PULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

Nr.848.Rep
Tirane, me 03.08.2007

VERTETIM:

Me anen e te cilit vertetoj se sot me daten 03.03.2007 (dymijeshtate), u paraqiten personalisht para meje Noterit Boris M. SKENDI, me Seli Rruga "Reshit COLLAKU", Pall. "Shallvareve" Nr.4 Tirane, dhe me kerkuan konfirmimin noterial te nenshkrimit te tyre ne kete Vendim te Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve te "CONTINENTAL GROUP" SH.A., redaktuar prej tyre jashte kesaj Zyre Noteriale me daten 29.01.2007 Zoterinjte: Shefqet KASTRATI, Leonard KASTRATI dhe Luigj ALIJAJ, per identitetet e te cileve u sigurova nepermjet dokumenteve ligjore te Shoqerise dhe atyre individuale qe mbajne me vete, si dhe per nenshkrimin e vullneteshem sipas deklarimit tetyre ne kete Zyre Noteriale, te tre madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pas une Noteri Publik i vertetoj ato sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".

NOTERI

Boris M. SKENDI

NOTER
TIRANE

PASAPORTE
PASSPORT

REPUBLIKA E SHQIPERISE / REPUBLIC OF ALBANIA



Tipi/Type: P
Kodi/Code: ALB
Nr.Pasaportës/Passport No.: Z1693711

Mbiemri/Surname: KASTRATI
Gjatësia/Height: 176CM

Emri/Name: LEONARD
Gjinia/Sex: M

Shtetësia/Citizenship: ALB
Syti/Colour of eyes: JESHIL

Datëlindja/Date of birth: 19 NOV/NEN 1984
Vendlindja/Place of birth: KRUME KUKES

Autoriteti lëshues/Authority: MRP
Nr.Personal/Personal No.: 03011451806303

Data e lëshimit/Date of issue: 16 DEC/DHJE 2005
Data e skadimit/Date of expiry: 15 DEC/DHJE 2015

Firma e mbajtësit/Holder's signature

P<ALBKASTRATI<<LEONARD<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<
Z1693711<3ALB8411198M15121550301145180630396

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** ___849___ **Kol.**
**Nr.** ___88___ **Rep.**

TAKSA E PULLES U PAGUA

# KONTRATË
## SHIT – BLERJE AKSIONESH

Sot, më datë 3 /3 /2007, para meje [signature], Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht, Shitësi dhe Bleresi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje aksionesh me termat e mëposhtme :

**SHITËSI :** Shoqëria z. Leonard Kastrati shtetas shqiptar i datëlindjes 19 / 11 / 1984 lindur në Krumë dhe banues në Durrës në adresën "Currila", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. Z 169371.

**BLERËSI :** Z. Shefqet Kastrati, shtetas shqiptar i datëlindjes 05.06.1961, lindur në Kukës dhe banues në Durrës në adresën "Currila", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar,i identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. 1513303.

**OBJEKTI:** Shitja e aksioneve të shoqërisë "Continental Group " sh.a. në masën prej 25% të aksioneve të kapitalit themeltar, aksione këto të zotëruara tërësisht nga z. Leonard Kastrati me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga Z. Shefqet Kastrati, me cilësinë e blerësit.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria Tregtare me emertimin "Continental Group" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 23554/2, datë 16/12/205 e cila me perpara ka pasur emertimin "Akus Group "sh.a shoqëri e themeluar me një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000.000 lekë me vendimin nr. 23554, datë 06.04.2000.

Me vendimin e datës 29.01.2007 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqerise "Continental Group" sh.a. , është vendosur miratimi i shitjes së aksioneve, nga aksioneri z. Leonard Kastrati në tërësinë e aksioneve që ai zotëron në masën prej 25% të kapitalit themeltar në favor të aksionerit tjeter te shoqerise z. Shefqet Kastrati

Shitja e totalit prej 25% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "Continental Group " sh.a., sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të aksionerit z. Leonard Kastrati në masën 25% të aksioneve , si pasojë e këtij transaksioni shitjeje të realizuar ndërmjet palëve.

Shitësi, është plotësisht dakort t'i shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, blerësit, Z. Shefqet Kastrati vlerën prej 25% të aksioneve të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Nga ana e tij blerësi, z. Shefqet Kastrati është plotësisht dakort që të blejë masën prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "Continental Group" sh.a. Pas këtij trasanksioni, blerësi z. Shefqet Kastrati fiton të gjitha të drejtat dhe detyrimet që sjell blerja e aksioneve ne masen 25% te tyre duke rritur perqindjen e zoterimit te aksioneve te tij ne kapitalin themeltar ne 50% te aksioneve .

Leonard Kastrati [signature] [signature]

**MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi, z. Leonard Kastrati humbet pronësinë mbi masën prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë "Continental Group" sh.a., duke humbur cilësinë e tij si aksioner i shoqërisë dhe duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi aksionet e kësaj shoqërie. Ndërsa blerësi, z. Shefqet Kastrati bëhet pronar i të gjithë aksioneve të shitura të kapitalit themeltar të Shoqërisë në masën 25% të tyre dhe gjithsej i mases 50% te kapitalit. te shoqerise

Pas realizimit të kësaj kontrate shit – blerje, aksionet e shoqërisë "Continental Group" sh.a., do të zotërohen në këtë mënyrë:

- Luigj Aliaj zotëron 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Shefqet Kastrati zotëron 50 % të aksioneve në kapitalin e shoqërisë

**ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE**

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje të aksioneve të shoqërisë tregtare "Continental Group" sh.a., do të jetë 25.000.000 (njëzet e pesë milion) lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të një aksioni.

Sipas këtij përcaktimi bleresi, Z. Shefqet Kastrati, paguan në favor të shitësit z. Leonard Kastrati shumën 25.000.000 (njëzet e pesë milion) lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrit Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time.

**PALËT**

**SHITËSI**
**Leonard KASTRATI**

Leonard Kastrati

**BLERËSI**
**Shefqet KASTRATI**

Shefqet Kastrati

**NOTER**